


Nr.regj. 16968/2010



GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Hysni Veseli nga fshati Broboliq, Komuna Mitrovicë, për kundërvajtje nga neni 6 paragrafi 2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK nr.23/79, me datë 15.04.2011 merr këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Hysni (Jetish) Veseli, i lindur 1968 në Mitrovicë, tani me vendbanim në fshatin Broboliq, Komuna Mitrovicë, i punësuar si Kryeshef Ekzekutiv në Ministrinë e Administratës Publike, i martuar, i gjendjes së mirë ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e s

Sepse, si Zyrtar i Lartë Publik në Ministrinë e Administratës Publike, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë në Angjencinë Kundër Korrupsionit, deri më datën 31.03.2011

- me veprim të tillë ka kryer kundërvajtje nga neni 6. 2 e ndëshkuar me nenin 16. Paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro), të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pasi ky aktvendim të merr formën e prerë, në dobi të AFQ të Drejtësisë në Prishtinë, në xhirollogarinë rrjedhëse nr.1000-4300-70000-518. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar komfor nenit 5 të LK, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) ditë, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgu.

Komfor nenit 109 të LK, në emër të paushallit gjyqësor, i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 10 (dhjetë euro) në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobës dhe e paushallit gjyqësor mund të bëhet në çdo bankë të qytetit të Prishtinës, ndërsa një kopje e fletëpagesës të kthehet në gjykatë.

Nga një kopje të këtij aktvendimi t'u dorëzohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

A r s y t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrroi kësaj gjykate kërkesën 01/2298/2010 me datë 15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, meqë i njëjti nuk e ka dorëzuar në Agjencinë kundër Korrupsionit formularin mbi deklarin e gjendjes së pasurisë deri më datën 31 mars 2010.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se në pozitë të Kryeshefit Ekzekutiv në Institutin e Kosovës për Administratë Publike është nga viti 2009 ku do të jetë deri më 09.05.2011, se në departamentin e tij me kohë ka ardhur formulari në emrin e tij për deklarim të pasurisë, por ai nuk e ka deklaruar pasurinë për vitin 2010, duke e parë si të panevojshme, meqë pasurinë e tij veç e kishte deklaruar në vitin 2009. Në vazhdim i pandehuri shton se nuk kishte konsideruar se vendi i tij i punës e obligon të bëjë deklarin e pasurisë e pastaj thekson se nuk kishte pasur kohë për ta plotësuar formularin për shkak të ngarkesave në punë.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit dhe shqyrtimi i shkresave të tjera të lëndës gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë së të pandehurit për këtë kundërvajtje dhe të njëjtin e dënoi me gjobën e paraparë ligjore.

Gjatë shqyrtimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe duke vlerësuar masën e shkeljes sipas pozitës së zyrtarit të lartë publik si dhe duke pasur parasysh personalitetin e tij, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me gjobë të precizuar si në diapozitiv të aktvendimit, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

Nr. Regj.16968/2010, datë 15.04.2011

Gjyqtarja
Suzana Cerikani

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, 8 ditë nga data e pranimit të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksë.

